



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:243978

Datë: 06.11.2023

Numri i dokumentit: 04876339

C.nr. 2615/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q.D, Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. B.A nga Peja, kundër të paditurës K.S.I Prishtinë, e përfaqësuar nga A.L sipas autorizimit, me objekt kontesti zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 3,490.00 Euro, në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqësve, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 26.10.2023, ndërsa me datë 01.11.2023, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Q.D, Komuna e Pejës, ashtu që:

- I. DETYROHET** e paditura K.S.I, në Prishtinë, që paditësit Q.D, në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar në aksidentin e datës 12.08.2021, t'ia paguaj shumat dhe atë për:

Demin jo material:

- a) në emër të dhimbjeve fizike shumen prej 1.000,00 Euro
- b) në emër të frikës shumën prej 800,00 Euro

Të gjitha këto si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi me kamatë ligjore prej 8%, nga data **01.11.2023** (dita e përpilimit të këtij aktgjykimi), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

- II. DETYROHET** e paditura K.S.I në Prishtinë, që paditësit Q.D, në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e datës 12.08.2021, t'ia paguaj shumat dhe atë për:

Demi material

- a) në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj shumen prej 70.00 Euro
- c) në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 150.00 Euro

Te gjitha këto si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi me kamat ligjore prej 8%, nga data 01.11.2021 (data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive e të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nen kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR, kërkesë padia e paditësit Q. D, përtej shumës së gjykuar, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për aksidentin e datës 12.08.2021, për shumat e specifikuar si më poshtë:

Dëmi jo material

- a) në emër të dhimbjeve fizike-trupore shumën prej 500,00 Euro
- b) në emër të frikës shumën prej 700,00 Euro

Demi material

- a) në emër të ë kujdesit dhe ndihmës së huaj shumen prej 70.00 Euro
- b) në emër të terapisë fizikale shumen prej 200.00 Euro

IV. DETYROHET e paditura K.S.I, në Prishtinë, që paditësit Q.D, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 833.00 euro, e të gjitha këto t'i përmbushë në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës K.S.I në Prishtinë, të njëjtën e ka precizuar me parashtresën e dt.17.10.2023, me objekt kontesti zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 3,490.00 Euro.

I autorizuari i paditësit me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi u vërtetua baza e kërkesëpadisë, po ashtu edhe lartësia e saj. Baza e kërkesëpadisë nuk ka qene kontestuese që nga fillimi e deri me tani, por kontestuese ka qene vetëm lartësia e demit. Lartësia e demit u vërtetua me nxjerrjen e ekspertizave nga lëmia e ortopedisë dhe e psikiatrisë, përkatësisht nga ekzaminimi i drejtpërdrejt që është bere në seancë dhe me dt. 17.10.2023 kam bere precizimin e kërkesëpadisë duke u bazuar ne mendimin e eksperteve të lartcekur, mirëpo precizimin e kam bëre duke u bazuar ne udhëzuesin e Gj.Supreme me nr 41/2023, te dt. 27.02.2023, i cili udhëzues parashih kriteret për caktimin orientues dhe lartësinë e shpërblimit te të drejtës në të holla, për demin jo material. I propozoj gjykatës që të aprovohet padia dhe precizimin e saj si i bazuar përkatësisht me vlerën prej 3,490 euro me kamate ligjore nga dita e parashtrimit të padisë. Po ashtu i propozoj gjykatës që edhe për shpenzimet procedurale të i aprovoj, shumen 104 euro për përpilim e padisë, 21 euro për takse gjyqësore, 3 seanca te mbajtura nga 135 euro, dhe për precizimin e padisë 104 euro, si dhe pagesën për ekspert 2x100 ne total 200 euro.

I autorizuari i të paditurës se me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e ne këtë çështje kontestimore mes palëve ndergjyqese gjate gjithë procedurës në asnjë rrethane nuk është kontestuar baza juridike e padisë, gjegjësisht

përgjegjësi subjektive e të paditurës për kompensimin e demit, por kontestuese kane qene pretendimet e paditësit lidhur me natyrën e lëndimeve. Edhe gjate ekzaminimit te drejtpërdrejt nga ekspertet gjyqësor është vërtetuar se pretendimet e paditësit lidhur me natyrën e lëndimeve nuk kane qene te bazuara. Dhe si përfundim nuk ehte paraqitur vërejtjeje as në konstatimet e mjekëve. Lidhur me precizimin kërkesëpadisë sa i përket demit jo material dhe formave te demit material për ushqimin e përforcuar dhe ndihmën e personit të huaj e kontestojmë pjesërisht, me arsyetimin se konsiderojmë se të njëjtat nuk janë te mbështetura, duke marre parasysh ekspertizat mjekësore, gjegjësisht kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, kohëzgjatjen e ndihmës se personit të trete, dhe me faktin se kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore. Ndërsa lidhur me demin material për terapi fizikale e kontestojmë në tërësi dhe gjykatës i propozojmë qe këtë forme të demit të e refuzoj me arsyetimin se nuk ka prova në shkresa të lëndes se paditësi i ka krijuar ato shpenzime, mare parasysh edhe kohen nga dita e kohës se ndodhjes se aksidentit deri në kohen e precizimit të padisë, që është një kohe e gjate dhe i njëjti nuk i ka realizuar rekomandimet e mjekut. Gjithashtu e kundërshtojmë propozimin sa i përket kamatës gjate kohës se rrjedhjes se saj dhe gjykatës i propozojmë në rastin e vendosje në këtë çështje kamatën për demin jo material ta gjykoj nga data e marrjes e aktgjykimit dhe për atë jo material nga data ushtrimit të padisë. Lidhur me shpenzimet e procedurës sa i përket seancës së pare dhe të dyte, shpenzimeve për ekspertiza mjekësore dhe për përpilimin e padisë gjykatës i propozojmë që të i gjykoj në baze të parimit të suksesit në procedure me arsyetimin se nuk janë vërtetuar pretendimet e paditësit sa i përket natyrës se lëndimeve, ndërsa për seancën e trete të shtyrë me kërkesën e palës paditëse dhe për kërkesën për precizimin këto shpenzime të refuzohen në tërësi meqenëse precizimin e kërkesëpadisë pala e ka ber rregullimin e padisë se vet e cila në baze të dispozitave te LPK nuk ka qene në rregull ashtu siç jemi deklaruar në përgjigje në padi, dhe këto shpenzime nuk mund të bien në barre te të paditurës.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjen faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: raporti fillestar i aksidentit i dt. 12.08.2021, procesverbali mbi vend shiqimin i dt. 13.09.2021, 8 fotot në bardhë-zi, raporti i spitalit te përgjithshëm në Pejë-Emergjenca i dt. 12.08.2021, ekspertiza e paraqitur nga ekspertet nga lamia e ortopedisë Dr. Florim Bajraktari dhe lamia e psikiatrisë Dr. Muhamet Halitaj, dhe deklarimet e përfaqësueseve të autorizuar te ndërgjyqësve.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 12.08.2021, rreth orës 9:50 minuta në Pejë, kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor me fajin e M.S, nga Peja, dhe se vetura me të cilën është shkaktuar aksidenti ka qenë me Polis të Sigurimit Kufitar, te këtu e paditura K.S.I, për çka edhe i autorizuari i të paditurës me përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë,

mirëpo kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë. Me nenin 321 të LPK-së parashihet se “*Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor*”.

Meqenëse në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese baza juridike në raport me shkaktarin e aksidentit, gjykata nuk u lëshua në arsyetimin e provave në raport me shkaktarin e aksidentit.

Sipas dispozitës së nenit 136.1 të LMD-së, parashihet se kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispozitën e nenit 159.1 parashihet se “*në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit*”.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga Dr. Florim Bajraktari – ortoped, dhe Dr. Muhamet Halitaj – psikiatër, të cilët në mendimet e tyre të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.10.2023, ku janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasoi e këtij aksidenti.

Eksperti nga lamia e ortopedisë Dr. Florim Bajraktari, ka deklaruar se: kemi të bëjmë me një lëndim të lehtë trupor, i cili në momentin e lëndimit është i përcjellur me dhimbje të intensitetit të lartë prej 20 min, intensitetit të mesëm prej 2 orë, intensitetit të lehtë se paku 2 javë, i njëjti ka pasur nevojë edhe për terapi fizikale për rikthim të forcës muskulore të muskulit të mbi gjurit të majte se paku 10 ditë. Ka pasur nevoje për ushqim të përforcuar se paku 2 javë, ndërsa ndihmën e personit tjetër ka pasur nevoje me se shumti 7 ditë. Zvogëlim të aktivitetit nuk ka. Gjithashtu eksperti gjatë ekzaminimit klinik të paditësit drejtpërsëdrejti në seancë ku i njëjti ka pretenduar se ka lëndime me të mëdha në këmbë dhe në dorë, eksperti ka deklaruar se vrehet ndjeshmëri e madhe e lëvizjet fleksore dhe ekstenzore të gjurit të majte, po ashtu vërehet dobësi muskulore e muskit kuadriceps të gjurit të majte. Po ashtu në dorën e djathtë gishtat 4 dhe 5 vërehet deformimet i fallonges distale të të dy gishtave që nuk posedojmë dokumentacion mjekësor në shkresa të lëndes për ditën e aksidentit. Dhe gjithashtu pas pyetjes së të autorizuarit të paditurës eksperti kishte deklaruar se siç e cekem edhe me lartë, ankesat në gjyq nuk korrespondojnë me natyrën e lëndimeve të shkresave të cilat i kemi në shkresa të lëndes, po ashtu ankesat në dorën e djathtë nuk janë fare të prezantuara në shkresa.

Eksperti nga lamia e psikiatrisë Dr. Muhamet Halitaj, ka deklaruar se: i askidentuari ka përjetuar frik primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo periudhë është e percjellurë me shtangim afektiv, frike sekondare të intensitetit të lartë ka pasur në periudhën kohore gjer në 2 orë, duke e llogaritur kohën nga momenti i aksidentit dërgimi i tij në Qendrën Emergjente të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, ku janë bërë ekzaminimet dhe rehabilitimi mjekësor. Frike sekondare me intensitet të mesëm ka pasur në kohëzgjatje prej 4 javë të manifestuar me një çrregullim të stabilitetit psiko-fizik si pasojë e aksidentit si in-disponim, pengesa të here pas hershme në gjumë, rikujtim të ngjarje traumatike dhe shkalle me të ulet të

tolerancës frustative. Frike sekondare me intensitet të ulet ka pasur në periudhën kohore gjer në tre muaj e që eshët manifestuar gjate kohës kur ka dale në komunikacion apo ngjarjet që ia rikujtojmë aksidentin.

Gjykata në tersi i ka falur besimin konstatimeve të eksperteve përkatës, të njëjtat përputhen në mes veti si dhe provat tjera e posaçërisht me dokumentacionin mjekësor që ju është bashkangjitur shkresave të lëndës dhe gjithashtu palët ndërgjyqësve pas deklarimit të eksperteve mjekësor nuk kanë pasur vërejtje në mendimin e tyre, për çka gjykata i fali besimin e plotë mendimit të eksperteve.

Për lartësinë e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e lidhur me nenin 323 të ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit jo material, mori parasysh natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kishte pësuar paditësi në aksidentin e ndodhur, mënyrën e manifestimit, intensitetit dhe kohëzgjatjen e frikës se përjetuar, sipas gjetjeve të bëra nga ekspertët mjekësor, moshën e paditësit të aksidentit, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi të jetë satisfaksion për paditësin, e duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e kompensimit në raste të tilla, praktikën e mirë gjyqësore, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, si dhe duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se “me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe qëllimin shoqëror”. Pra, nga kjo dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballje të tejkalimit të pasojave që në këtë rast paditësi ka pasur në aksidentin e datës 12.08.2021.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarin, çka në rastin konkret shumat e gjykuara si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë të drejta për paditësin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe*

fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit". Në këtë rast paditësi i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, edhe përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësit Q.D, ka pasur nevojë për ndihmë të huaj në kohëzgjatje prej 7 ditësh, dhe ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej dy javësh (14 ditësh), ku të njëjtit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin jo material, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejt.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin material si ndihmë dhe kujdes të huaj ne shumen prej 70 euro, pasi që gjykata vlerëson se paditësi nuk e ka argumentuar me asnjë provë kërkesën e tij për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që sipas dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Ndërsa sa i përket kompensimit për terapi fizikale pala nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme në bazë të cilës do të vërtetonte pretendimet e veta që të i kompensohet kjo kategori e dëmit material, andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, për dëmin jo material konsideron se nga momenti i përpilimit të aktgjykimit (datë 01.11.2023) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket dëmit material gjykata konsideron se nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë (data 01.11.2021) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për dëmin e shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse ne këtë procedurë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 833,00 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i

referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, taksën për padi shumë prej 20 euro, për ekspertiza mjekësore të ekspertëve mjekësor shumë prej 200 euro, për tri seanca të mbajtura për secilën nga 135.00 x 3=405.00 euro, dhe shumen 104 euro për precizimin e kërkesëpadiës).

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:243978 - C.nr.2615/21, 06.11.2023**

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, në Gjykatën
e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.